



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KËSHILLI I BASHKISË MEMALIAJ

Nr. 2137 / 3 prot.

Memaliaj më 30.09 .2025

Procesverbal

I mbajtur sot më datë 30.09.2025 në sallën e Këshillit Bashkiak Memaliaj në katin e parë të bashkisë Memaliaj zhvillohet mbledhja e radhës e Këshillit.

Ora e fillimit të mbledhjes ora 13:10.

Kryesuesi i mbledhjes Z. Erjon Sinanaj/ Kryetar këshilli.

Këshilltarë pjesëmarrës në momentin e fillimit të mbledhjes 11 Këshilltarë.

Përhëndetje të nderuar këshilltarë!

Siç jeni në dijeni vazhdon e njëjta situatë ku administrata nuk ka sjellë asnjë material në mbledhjen e Këshillit. Mbledhja e sotme do të zhvillohet sipas rendit të ditës me nr.2137/2 prot, datë 23.09.2025.

●Pika 1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.

Flamur Mushamati: Ne u takuam me kryetarin e bashkisë dhe i thamë: Pse vazhdon kështu? Ai na tha: Kryetari i Këshillit ka shkelur ligjin, duke mos bërë mbledhje jashtë radhe.

Po në rregull i thashë, po kështu ndëshkohen qytetarët .

Po ja tha:- mos e shkelte ligjin.

Po çfarë do të bëhet?- i thashë unë . Ka ndonjë mënyrë për të zgjidhur këtë problem?

Po. - tha ai- Të ulemi ti sqarojmë gjërat . Tani dua të di : - A keni bërë takim apo jo?

Kryetari i këshillit: Jo nuk kemi bërë takim. Unë e kam thënë që të diskutojmë që kur kemi dërguar kërkesë për interpelancë.

Flamur Mushamati: Ne vimë këtu bëjmë mbledhje nuk është gjë e mirë se i mblodhëm apo si mblodhëm ato lekët e Këshillit nuk është ndonjë gjë kushedi po për qytetarët është problem.

Erjon Sinanaj: Nuk është ajo primarja jonë të marrim apo mos të marrim ato lekët e këshillit po çështja është se kryetari nuk ktheu as përgjigje as përfaqësues nëse ishte i zënë dhe nuk kishte mundësi të vinte, as përgjigje me shkrim s'ka dërguar kjo nuk ka ndodhur dhe ky takim faktikisht nuk është se ka ndodhur.

Flamur Mushamati: Edhe nëse takimi ndodh ai thotë se ka njoftuar instancat dhe do ta ndjekë në rrugën ligjore.. Po ku do të shkojmë kështu? Nuk është gjë e mirë kjo e kam thënë dhe herë tjetër dhe këtë nuk e them me asnjë tendencë.

Erjon Sinanaj: Flamur, unë të falënderojë për ndërhyrjen që bërë dhe përsa i përket asaj pjese të rrugës institucionale që mund të ndiqet nga të dyja palët si nga Këshilli Bashkiak, qoftë dhe bashkia le të ndiqet, po problemi është se ajo që ju e thatë vet po merren më qafë qytetarët. Pse duhet të bllokohen vendimet për ndihmat? Po përsa i përket pjesës institucionale le të ndiqet. Unë nuk e di çfarë përgjigje iu është dhënë juve, përveç anës institucionale.

Flamur Mushamati: Të ulemi të sqarohemi, ai pranon.

Esmerald Xhemali: Për procedurë apo për çfarë ishte kjo? Tani në lidhje me procedurën për miratimin e rendit të ditës. Në datën 18 shtator kemi marrë një njoftim në grup që ka filluar funksionon faqja e web-it dhe kërkojnë CV-in. Tani dua të bëj një pyetje, po kujt t'ia drejtojmë këtë pyetje? Çfarë është bërë në lidhje me vendimet e kryesisht me p/vendimet që kanë qenë të pasqyruara në web, kanë vazhduar? Web-i fillon nga CV-ja e tutje apo do të hidhen dhe ato që nuk kanë qenë? Sepse s'kemi pse kërkojmë nëpër arkiva kur mund t'i gjejmë në web. Këtë pyetje kisha, nuk di kush mund të më përgjigjet?

Erjola Allka/ sekretare këshillit: Po Z.Kryetar siç jeni në dijeni prej një kohe të gjatë tashmë, ndoshta 1 vit apo pak më shumë web-i nuk ka funksionuar. Ne filluam të abëdojmë faqen e web-it dhe të plotësojmë sipas rubrikave duke filluar me CV e Këshilltarve dhe materialet e mbledhjes së fundit të cilat janë hedhur dhe mund t'i gjeni në faqen web. Për të tjerat do të duhet pak kohë për t'i hedhur të gjitha pasi duhen skanuar përsëri. Disa janë dërguar te email-i i IT-së së bashkisë. Do ti gjejmë dhe do ti plotësojmë të gjitha për gjithë muajt që web nuk ka funksionuar. Edhe vendimet gjithashtu do ti skanojmë përsëri që nga muaji janar 2025. Ndërsa për vendimet e vitit 2024 do të duhet kohë pasi janë dorëzuar në arkivë, kështu që do të duhet kohë të koordinohen zyrat.

Esmerald Xhemali: Po janë dërguar me email aty janë ato s'ka nevojë të skanohen përsëri. Kjo është urgjente.

Erjola Allka/ Sekretare këshilli: Besoj se do ta gjejmë një zgjidhje me administratën, jemi duke punuar për këtë pjesë.

Esmerald Xhemali: Duhet vënë dhe një afat dhe duhet vënë në fokus plotësimi i faqes web.

Erjon Sinanaj: Vazhdojmë me votimin për miratimin e rendit të ditës për mbledhjen e datës 30.09.2025 si më poshtë:

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 10.09.2025.
3. **Projekt vendim:** "Për dhënien e ndihmës ekonomike (fondi i kushtëzuar 6% i bllok-ndihmës ekonomike) për muajin gusht 2025".
4. **Projekt vendim:** "Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin shtator 2025".
5. **Projekt vendim:** "Mbi shfuqizimin e vkb-së nr. 34, datë 29.09.2021 "Për ndërprerjen e shpërblimit të këshilltarëve të cilët nuk e justifikojnë ushtrimin e detyrës së këshilltarit të Këshillit Bashkiak".
6. Informacion nga drejtoria e financës "Mbi raprtin e buxhetit (në të ardhurat dhe shpenzimet) për 8- mujorin e vitit 2025, kërkesë sipas planit të punës së këshillit.
7. Informacion mbi pagesën e shpërblimeve të këshilltarëve për periudhën janar-gusht 2025 me kërkesë t; Z.Asqeri Muçoima.

Hidhet në votim.

Vota Pro 11 vota.

Vota Kundër 0 vota.

Vota Abstenim 0 vota. Miratohet.

●Pika 2 e rendit të ditës: Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 10.09.2025.

Hidhet në votim.

Vota Pro 10 vota.

Vota Kundër 0 vota.

Vota Abstenim 1 votë. Esmerald Xhemali. Arsyeja, nuk ka qenë në mbledhje.

●Pika 3 dhe 4 e rendit të ditës: **Projekt vendim:** “Për dhënien e ndihmës ekonomike (fondi i kushtëzuar 6% i bllok-ndihmës ekonomike) për muajin gusht 2025” dhe **Projekt vendim:** “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin shtator 2025”.

Normalisht sot duhet të kishim materialet për 6% i cili u ka munguar qytetarëve që nga muaji qershor, korrik, gusht dhe ne shpresonim që ti kishim sot këtu qoftë projekt vendimet, qoftë relacionet por nuk kemi kështu që jemi të detyruar të vazhdojmë, nuk e di kjo është një situatë që nuk duhet të ishte kështu por në këto kushte jemi nuk kemi çfarë të bëjmë. Ne nuk kemi çfarë të miratojmë për këtë pikë pasi nuk kemi materialet nga ana e administratës.

Esmerald Xhemali: Në lidhje me këtë projekt vendim i cili mungon, doja të bëja një pyetje: Pse është futur në rend dite kur nuk është sjell materiali përkatës e para, edhe tjera sipas rregullores është që këshilltarët duhet ti sjellin 5 ditë para materialet, 5 ditë pune, pastaj duhet ti kalojmë dhe në komisione këtu është e kotë që të diskutojmë se është futur në rend dite pa ardhur materialet të vinin sot unë personalisht do të votoja sepse rregullorja thotë do kohë për të shqyrtuar.

Erjon Sinanaj: Do të sqaroja unë për këtë pjesë ne si këshill kemi të drejtë ti çojmë këto pika në rend të ditës dhe nga ana tjetër është administrata ajo që duhet ti sjellë projekt vendimet dhe relacionet sipas ligjit 139/2015 neni 64. Pra ligji na i jep këtë të drejtë. Për pjesën tjetër e sqaroja më lart.

Esmerald Xhemali: Do të ishte më mirë që në fillim të mbledhjes unë të propozoja një ndryshim të rendit të ditës. Do të qe më me vend por po e lë për muajin tjetër.

Erjon Sinanaj: Edhe ajo mund të ndodhte, ne mund ta bënim edhe atë ndryshim dhe për pikën 3 dhe 4 ne nuk kemi çfarë të diskutojmë se është administrata ajo që i sjell dhe i mbron dhe pastaj ne diskutojmë.

Asqeri Muçoima: Pika 3 dhe 4, mirë është bërë që janë vendosur sepse këto janë të përmuajshme, por shpreh keqardhjen time sepse ka 3 muaj që qytetarët nuk po marrin atë thesin e miellit që thamë herën e kaluar, është për të ardhur keq. Unë e falënderoj edhe Flamurin për informacionin që dha për takimin me kryetarin e bashkisë por kryetari nuk ka pse të thotë kisha axhendë dhe nuk vija dot kur ai shumë mirë mund të delegonte një person tjetër që të vinte ose të njoftonte para mbledhjes së Këshillit ku thoshte do të më falni por unë nuk marr dot pjesë, më lini një datë tjetër nëse do të gjykojmë tamam me logjikë. Edhe mua më ka thënë jam gati të ulem këtu e dy muaj para kur unë u fjalosa me të. Le të vij ja këtu është këshilli, le të ulet, le të diskutojmë, nuk është puna për Asqeriu se i janë prerë dy muaj padrejtësisht. Ai e ka shkelur ligjin me të dyja këmbët sepse dhe ai vendim nuk është i bazuar në ligj. Le ta marri vesh dhe kryetari se nëse thotë se unë kam inat se nuk u mbledh këshilli se i kërkova një mbledhje jashtë radhe. Shumë e drejtë e ka të drejtë të kërkojë po ka dhe një sqarim tjetër ajo pikë tjetër ku thuhet se ka dhe një afat kohor dhe n.q.se është problemi për një pikë të rendit të ditës që këshilli nuk ia ka aprovuar. Nuk mund të na mbledh ai sa herë të dojë ai dhe kur të dojë ai. Ashtu siç pretendon se për ne ka ligj dhe për kryetarin e bashkisë ka ligj, të jemi të qartë në këtë pikë. Kryetari i këshillit ka bërë një lapsus në përgjigjen që i ka kthyer duke i thënë që këshilltarët janë me pushime, jo ky nuk është argument.

Erjon Sinanaj: Mos i ngatërro gjërat kam thënë me leje vjetore.

Asqeri Muçoima: Mirë me leje vjetore, do ti thoshe për këtë pikë që kërkon ti mbledhje jashtë radhe e ke të jashtëligjshme vëlla. Nuk mbledh këshilltarë unë se do ti. Po na krijohet problemi me popullin sepse populli nuk e di se çfarë kemi bërë ne si këshill. Populli di kryetarin e bashkisë, janë me fakte këto dhe kryetari i bashkisë u ka thënë se ka votuar këshilli. Populli po na ashtu ne për gryke.

Erjon Sinanaj: Ja ku jemi live dhe kjo që sapo the nuk qëndron.

Asqeri Muçoima: Mirë mo, nuk qëndron por ne duhet të sqarojmë dhe njerëzit. Për sot është vënë njoftimi për mbledhje?

Erjon Sinanaj: Po është te faqja e web- it dhe të Fb-së së Këshillit në këndin e njoftimeve.

Asqeri Muçoima: Na ënjtjet me këtë faqja, faqja, populli nuk hyn te faqja. Te stenda të vendosen njoftimet.

Sekretarja: Po janë vendosur te zyrat e bashkisë.

Erjon Sinanaj: Të mos dalim nga rendi i ditës, pra për dy projekt vendimet për ndihmat ekonomike nuk kemi çfarë të kalojmë.

Asqeri Muçoima: Duhet të sqaruar dhe duhet thënë e vërteta për njerëzit. Kush po i bllokun? Ne që ngremë kartona jeshil apo administrata që nuk i bie se duhet thënë, duhet parë çik mirë se më duket se dhe administrata, vërtetë është marrë në punë nga kryetari i bashkisë por dhe ajo punon në bazë të një ligji. N.q.se nuk kryen detyrën administrata pushohet nga puna, duhet parë thellë kjo punë e duhet studiuar edhe me jurist sepse ata zbatojnë urdhrin e kryetarit por dhe ata duhet të shohin veten e tyre dhe ti thonë Kryetarit sikur s'shkon kjo punë kështu. Se më tha dhe mua kryetari se s'ke ardhur në punë dhe s'të jap lekë. Ai kujton se më ka punësuar mua. Imagjino ku shkon. Unë s'jam i punësuar nga kryetari i bashkisë dhe si erdha në punë. Mua më ka zgjedhur populli dhe më ka zgjedhur dhe me emër ashtu siç është zgjedhur dhe ai e gjithë të tjerët. Nuk voton ashtu qorrazi populli, ashtu siç votoi atë votoi dhe ne, po thotë jo s'vjen në punë këshilltari. Jo s'jemi të punësuar ne. Ne e kemi marrë nga populli mandatin dhe do ti përgjigjemi atij me 6% që se bie administrata. Kjo është e tmerrshme. Erjon Sinanaj: Shumë e drejtë ajo që thotë profesori. Ne do të kalojmë tek pika e pestë.

•Pika 5 e rendit të ditës: "**Projekt vendim:** "Mbi shfuqizimin e vkb-së nr. 34, datë 29.09.2021" Për ndërprerjen e shpërblimit të këshilltarëve të cilët nuk e justifikojnë ushtrimin e detyrës së këshilltarit të Këshillit Bashkiak".

Xhevit Kacorri: Pa kaluar tek pika 5 dua të flas dua të flas për pikën 3 dhe 4 të rendit të ditës për arsye se ne jemi pro për zhvillimin dhe dhe mbështetjen për komunitetin për çdo lloj pike të rendit të ditës që na vjen sidoqoftë për vendimet e ndihmës ekonomike, pra është dhënie e një sinjali pozitiv kryetarit të bashkisë, administratës që ne jemi për bashkëpunim dhe zgjidhjes së problemeve që janë stisur artificialisht ndërmjet institucionit të Këshillit Bashkiak dhe bashkisë. Kështu që unë them të ulim tonet dhe të afrohem për bashkëpunim dhe populli të marr atë qeverisje që meriton dhe të marr vëmendjen e duhur sepse kanë kaluar 3-4 muaj këto fonde janë djegur për shkak të kësaj situate që po kalojmë. Unë mendoj se është vepruar mirë nga ana e KB dhe lind pyetja: Pse administrata nuk reflekton në këtë pikë kështu që del për detyrë që gjithësecili të kryej detyrën në bazë të ligjit dhe rregullave për të cilat paguhet. Qoftë kryetari i bashkisë, qoftë administrata, qoftë specialistët, qoftë këshilltarët sepse populli nuk na e ka borxh. Kaq kisha.

Erjon Sinanaj: Faleminderit Xhevit edhe diskutimi juaj është me vend sepse me thënë të drejtën edhe unë kam pritur që të vinin projekt vendimet dhe relacionet dhe kam qenë optimist por shoh që nuk kanë ardhur deri në këtë moment që ne jemi duke zhvilluar mbledhjen.

Petrit Lumani: Unë e mirëkuptoj shumë mirë Xhevitin edhe ajo thirrja, unë do të isha dakord. Por ne nuk kemi mundësi si ti kalojmë këto verbalisht ose ti miratojmë kjo e para. E dyta unë në drejtim të anëtarëve të këshillit meqenëse u fol dhe përgjigjen që mori Lauresha edhe Flamuri të cilët shkuan

dhe pyetën, ne nuk kemi ngritur tonet që të ulemi por përkundrazi kemi treguar durim maksimalisht. Unë sapo u ndava tani edhe nga një grup njerëzish të cilët e telefonuan kryetarin e bashkisë dhe unë isha atje rastësisht . E telefonuan meqë pas ca ditësh në qytetin e Tepelenës vendoset busti i Tafil Buzit dhe kanë kërkuar nga bashkia një mbështetje financiare. Përgjigjen e kryetarit të cilën e dëgjova, ishte nuk e miraton këshilli këtë problem.

Flamur Mushamati: Faktikisht ashtu është profesor , keni qenë ju që e keni drejtuar mbledhjen. E ka rrëzuar këshilli , votoi Xhevit dhe Bujari kundër. Pse të bëhet në Tepelenë dhe mos të bëhet këtu?

Petrit Lumani: Pse ashtu është Flamur ? Jo e ka mirë Flamuri, mbase ka të drejtë.

Xhevit Kacorri: Për fondet mbështetëse unë jam pro. Vendosi është tjetër gjë pastaj. Me shumicë nuk u votua.

Petrit Lumani: Atëherë po them me sinjeritetin maksimal unë këtu kërkoj ndjesë, kryetari i bashkisë ka pasur të drejtë e ka prurë, këshilli nuk e di atë punë po na rëndon fakti që se kemi votuar .

Erjon Sinanaj: Kjo është një pjesë por ne po diskutojmë për këtë që kemi në rend dite., pika 3 dhe 4. Këto janë dy projekt vendime që janë shqetësuese sepse janë për ata njerëz që janë në nevojë, që ndoshta mezi presin që t'ju hidhet pagesa e cila po ju mungon prej tri muajsh duke filluar që nga qershori. Pastaj ti kthehemi diskutimeve të mëparshme . Unë vet do të isha Pro , por nuk mbaj përgjegjësi për të tjerët.

Asqeri Muçoima: N.q.se nënkryetari thotë se kryetari i bashkisë është shprehur se nuk e ka kaluar këshilli fondin për Tafil Buzin e vërteta është këshilltarët nuk kanë kundër pasi në muajin maj kanë kaluar për Petrit Rukën e kam ngritur edhe temë dua të dal se nuk kemi qenë kundër.

Petrit Lumani: Asqeri po ta them hapur nuk ka marr votat e duhura.

Xhevit Kacorri: Replikë/ Unë si këshilltarë i përmbahem rendit të ditës se çfarë të vjen ty profesor në mendje unë nuk mbaj përgjegjësi. Kam thënë jam pro fondit është anashkaluar nga lbapo 2 këshilltarë sepse i jep një suport shumë të mirë Bashkisë Memaliaj sepse është nga Bashkia Memaliaj. Por për fondet ishin të gjithë Pro , por numri i këshilltarëve ishte i kufizuar. Është akoma ai mentaliteti që Tepelena është rreth. O burra çoini të gjitha me kuq e me maq në Tepelenë. Jemi bashki më vete , kemi autoritetin tonë . Ky ishte mesazhi që donin të përcillnin këshilltarët.

Erjon Sinanaj: Xhevit ju sqaruat pozicionin tuaj në lidhje me atë projekt vendim që nuk është pjesë e rendit të ditës. Nëse vjen përsëri do ta diskutojmë.

Asqeri Muçoima: Unë nuk mund të mbaj përsipër një përgjegjësi që s'më takon. Vendin e zgjedh shoqata.

Petrit Lumani: Ishe në mbledhje ti? Vije në mbledhje dhe e votoje.

Asqeri Muçoima: Tafil Buzi vendin e ka përcaktuar vet qëkur erdhi nga deti dhe kaloi nga Labëria.

Bujar Mamaj: Ku kaloi? Nga kaloi na e tergo të vemi të vemi ta çojmë atje . Ti ke mendimin tënd profesor ne kemi tonin. Mos e prano!

Erjon Sinanaj: Ju profesor ashtu si dhe unë nuk keni qenë të pranishëm në atë mbledhje. Tani kështu ka ndodhur? Mirë apo keq? Nëse vjen prapë mbetet për diskutim . Ju lutem qetësi.

Petrit Lumani: Dhe këto debate të mira janë sa për të bërë mbledhje se këtu bereqet s'ka. Këtu ka një ngërç të madh . Për numrin e kufizuar këshilli se ka kaluar.

Bujar Mamaj: Në lidhje për Tafil Buzin që u diskutua dhe të vij prapë do ta votoj kundra. Unë fola dhe me Z. Medi se nuk e dija që kishte dhënë dorëheqje, e pyeta për vendosjen në Tepelenë dhe ai nuk ishte dakord , bile jo në qendër po në hyrje tek ura që ta shihnin të gjithë. Ne jemi bashki më vete e dyta në qark , ta respektojmë këtu se i takon kësaj bashkie.

Erjon Sinanaj: Vazhdojmë me pikën 5 të rendit të ditës. Materialet i keni para.

Bujar Mamaj: Ky vendim që duam të shfuqizojmë këtë thotë dhe rregullorja, ky vendim nuk hedh poshtë rregulloren. Ku e gjen të drejtën të hedh poshtë dhe të pres pagën e këshilltarëve. Për mendimin tim kjo është një injorancë totale. Kjo është të veprosh kundër ligjit.

Esmerald Xhemali: Ne kemi kritikuar kur na kanë ardhur materiale pa relacione dhe tani kemi ardhur këtu në një moment të cunguar. Kush e ka përgatitur këtë material ? Nga komisioni? Tek relacioni duhet të jetë kopja e këtij vendimi bashkangjitur. Ky relacion nuk shkon në prefekturë? Komisionit po ia drejtoj pyetjen.

Erjon Sinanaj: Është bërë një kërkesë nga këshilltarët në mbledhjen e kaluar . Komisioni I rregullores dhe mandateve është mbledhur dhe ka përgatitur relacionin përkatës. Mund të përgjigjet Xhevit si anëtarë komisioni .

Xhevit Kacorri: Vendimi i parë i këshillit bashkiak kishte si motiv për të frenuar mungesat e këshilltarëve duke qenë se ishin një ngjyrë për të rregulluar marrëdhëniet e brendshme të atij këshilli. Ky vendim është keqpërdorur nga administrata e tanishme dhe është përdorur dhe është përdorur si armë kundër këshilltarit për të penalizuar ato shpërblimet të janë me ligj të cilat këshilltari merr pjesë në aktivitete të ndryshme që monitorohen nga kryetari i këshillit bashkiak dhe pjesëmarrja e këshilltarit justifikohet nga kryetari i këshillit duke u mbështetur në këtë monitorim.

Petrit Lumani: Këshilli i mëparshëm ka bërë një rezolutë a vendim që të ndëshkojë në këtë mënyrë. A keni të drejtë ne të marrim një vendim deri në përjashtim apo shkarkim të këshilltarit ? Ata kanë marrë një vendim të mos paguajnë. A mos ka të drejtë bashkia të heq edhe një këshilltar apo këshillin të gjithë sepse i kanë dhënë një armë se si t'ia heq veshin këshillit.

Asqeri Muçoima: Penaliteti për këshilltarin është heqja e mandatit nëse nuk merr pjesë për 6 muaj rresht në mbledhje.

Erjon Sinanaj: Ju lutem janë pyetje që përgjigjet i dimë të gjithë.

Asqeri Muçoima: Kam një propozim që të shtohet 1 pikë ku të thuhet : Shpërblimi i këshilltarit të bëhet vetëm mbi bazën e listëprezencës të paraqitur nga kryetari i këshillit.

Esmerald Xhemali: E ke kuptuar gabim se ti nuk po bën ndryshim vendim po shfuqizon vendimin .

Asqeri Muçoima: Anuloj të parin dhe ia bëj të qartë.

Arsola Muzha: Lexoje pak pikën 2 , profesor.

Erjon Sinanaj: Në momentin që ai vendim shfuqizimin çdo gjë tjetër në vazhdim është sipas ligjit dhe rregullores në fuqi.

Edmonda Harizi: Ne jemi mbledhur sot këtu të shfuqizojmë një vendim të këshillit të mëparshëm. Po ky vendim është i mbështetur diku? Nëse ky vendim nuk është i mbështetur në ligj e kemi shumë të thjeshtë dhe themi : Ne e shfuqizojmë këtë vendim për arsye se nuk është i mbështetur në ligj. Në rast se nuk është i mbështetur në ligj e kemi shumë të thjeshtë. O Xhevit të lutem ta mbaroj mendimin. Ata mund ta kenë gati në vendimin e vet . Por ne nëse ai vendim që është marrë është i jashtëligjshëm d.m.th që është marrë kot .

Xhevit Kacorri: Është për konsum të brendshëm është për KB.

Arsola Muzha: Atëherë nëse lexojmë vendimin për zbatim ai vendim i ngarkohet sekretarit të këshillit. Unë për çdo komision për çdo veprimtari që kryej nuk kam pse ti jap llogari kryetarit të bashkisë apo administratës. Për çdo veprimtari që kryej si këshilltare unë do të vi të paraqitem këtu. Edhe raportin që plotësova dje gjatë komisionit e paraqita te kryetari i këshillit edhe nuk e kuptoj pse duhet bashkia të fusi hundët dhe të kërkojë dokumenta se ku bazohet, unë e vërtetoj sepse ligji dhe rregullorja e ka që e çon kryetari dhe sekretarja e këshillit listëprezencën, ai më heq shpërblimin ,kjo është kapërcim kompetence.

Flamur Mushamati: Në lidhje me këtë vendim, mendoj se ka qenë i gabuar sepse ka rregullore , ka ligj që e përcakton kështu mendoj unë.

Erjon Sinanaj: Administrata e bashkisë duhet të bazohet në listë prezencën që çohet nga ana jonë sipas ligjit dhe rregullores.

Esmerald Xhemali: Në lidhje me konkluzionin që edhe arritëm ne po anulohet një vendim që s'duhet të ishte vendim sepse këtij vendimi i është referuar financa dhe i pret shpërblimin këshilltarit. Kjo s'ka kuptim fare. Pa logjik. Pse mos të kërkojmë ne të bëhet pagesa sepse kush e vërteton pjesëmarrjen në aktivitet.

E vërteton këshilli, kryetari dhe të vazhdojë të paguaj ai zotëria, atëherë ne këtu anulohet sa herë të duam . Po shfuqizimi i këtij vendimi nuk e zgjidh këtë problem. Po neve më shumë na intereson të zgjidhet problemi.

Kryetari i këshillit: Ne po diskutojmë këtu për diçka që e kemi propozuar vet.

Bujar Mamaj: Ajo që kanë bërë ata është shkelje flagrante e ligjit. Me atë feste siç e duan do tu përgjigjemi. Injoranca do ofenduar . Ky vendim është i njëjtë me rregulloren s'ka asnjë ndryshim. Kryetari e hedh projekt vendimin në votim.

Vota Pro 9 vota

Vota Kundër 0 vota.

Vota Kundër 2 vota . F. Mushamati, L. Lila. Miratohet.

Vazhdojmë me pikën 6 të rendit të ditës.

● Pika 6 e rendit të ditës. Informacion nga drejtoria e financës “Mbi raprtin e buxhetit (në të ardhurat dhe shpenzimet) për 8- mujin e vitit 2025, kërkesë sipas planit të punës së këshillit .

Esmerald Xhemali: Po bashkia ka ndonjë plan se kur harrojnë PBA - në në sirtar vinë për mbledhje jashtë radhe. Kaloi viti i parë asnjë analizë po ikën i dyti po njësoj. Nisur nga situata e krijuar unë kërkoj që këto marrëdhënie të jenë reciproke të mos i tolerojmë më. Jo se na vjen keq për X specialistë se se ka bërë aty ta kalojmë. Duhej të ishin këtu informacionet . Se kur vjen puna kërkohet hajde të ulemi ne , po ne ulur jemi ku të ulemi më , të shtrihemi barkaz ne. Kështu që kjo nuk e realizoi edhe qëllimin , unë them ta mbyllim se u kënaqëm .

Erjon Sinanaj: Për ta mbyllur do ta mbyllim pak më vonë, por unë jam dakord për sa the më lart. Jam plotësisht dakord. Ne si këshill i kemi në planin tonë, administrata nuk ka sjellë përsëri gjë, duhet nga ana e tyre të kenë një reflektim. Unë nuk e di se çfarë po bëjnë?

● Pika 7 e rendit të ditës propozuar nga Asqeri Muçoima.

Informacion mbi pagesën e shpërblimeve të këshilltarëve për periudhën janar-gusht 2025 me kërkesë të Z.Asqeri Muçoima.

Asqeri Muçoima: Edhe kjo pikë lidhet me pikat e tjera të rendit të ditës. Në vazhden e atyre administrata e bashkisë së bashku me kryetarin e bashkisë janë kokëfortë, nuk duam të bashkëpunojmë më kështu.

Bujar Mamaj: Ore është në detyrë kryetari i bashkisë se mos është me raport e s'dimë gjë.

Asqeri Muçoima: Më vjen keq për këto raste por kam dy probleme të tjera: 1) Shqetësimi i pensionistve që kanë dal nga salla. Unë di që ka pasur një vendim që ata janë vendosur atje. Sekretarja ka për detyrë të kërkoj në arkivë atë vendim për vendosjen e sallës në Pallatin e Kulturës. 2) Më ka shprehur shqetësimin një biznesmen në Krahës për taksën e pastrimit. Dua sqarim për këtë problem kaq ka qenë apo është marr nga ne kur kemi miratuar taksat.

Erjon Sinanaj: Kjo taks ka kaluar në komision para se të miratohej në këshill, prandaj po ja lë fjalën Esmeraldit.

Esmerald Xhemali: Kjo taksë i përket një periudhe tjetër pra këshillit të mëparshëm ka bërë një rritje galopante të kësaj takse gati 3-fishim nga ana jonë është bërë një rritje e vogël.

Edmonda Harizi: Është bërë 15.000 lekë të reja po e mbani mend se ishte bërë një lapsus.

Petrit Lumani: Këshilltarë ju e patë se sa e vështirë ishte kjo mbledhje me kokëfortësi dhe pak përpërgjegjshmëri ka ,që të mos vij shtetari ti shërbej qytetarit. Ju kryetar në mbledhjen e ardhshme të kërkojmë praninë e prefektit dhe juristët të cilët mund të na ndihmojnë për të përmirësuar këtë situatë. Unë e kërkoj nga ana ime këtë që në mbledhjen e ardhshme të mos vimë kështu se është turp s'dimë çfarë po bëjmë. Prefekti ka detyrim institucional , ligjor , bashkëveprues midis problemeve të pushtetit vendor. Pastaj ai e di vet të vi të dëgjoj problemet të marri dhe juristë. Kaq kisha unë. Duhet të ndryshojnë gjërat.

Erjon Sinanaj: Faleminderit Z.Nënkryetar i këshillit! Do ti shohim gjërathap pas hapi në vazhdimësi.

Unë mendoja se do të ishin sot materialet. Kemi dhe një shkresë që na e solli znj. Lauresha Lila. "

Njoftim për rifreskim të kryetarit të grupit tonë BF". Shkresa bashkangjitur. Në bazë të rregullores është i qartë kryetar i grupit BF.

Xhevit Kacorri: Unë u befasova se nuk isha në dijeni. Ata lanë vizionin e tyre , vendimmarrjet e mia kanë qenë të drejta 50 + 1. Unë do të vazhdojë të aderojë në grupe të tjera dyert i kam gjithmponë të hapura por kuptohet do të qëndrojë në opozitë. Faleminderit!

Kryetari i këshillit e deklaroi mbledhjen të mbyllur.

Këshilltarë pjesëmarrës.

1. Erjon Sinanaj
2. Arsola Muzha
3. Esmerald Xhemali
4. Xhevit Kacorri
5. Maltona Bërxi
6. Lauresha Lila
7. Flamur Mushamati
8. Bujar Mamaj
9. Asqeri Muçoima
10. Edmonda Harizi
11. Petrit Lumani

Sekretari i Këshillit
Erjola Allka

Kryetari i Këshillit
Erjon Sinanaj

